



KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
 SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
 MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VI/2018

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VI (Gjashtë) të rregullt për vitin 2018 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 31.05.2018
Ora : 13.00

Prezentë në takim:

z. Nexhat Ramadani	z. Rilind Krasniqi	
z. Bashkim Ndrecaj	z. Jeton Rakaqi	
z. Ardian Shala	z. Arbërim Basha	
z. Alban Berisha	z. Dardan Berisha	Të pranishëm të tjerë
z. Shefket Kolgeci	znj. Marigona Gashi	Kryetari Komunës
z. Xhemajl Kabashaj	znj. Florie Bytyqi	Medjat dhe qytetart
znj. Elmaze Bytyqi	z. Sami Hajdari -	OSCE, LMT, KDI
znj. Bulëza Kuçi	znj. Albana Bytyqi	Habibe Bytyqi
znj. Shqipe Ramaj	z. Osman Selimaj	Xheladin Sadikaj, etj
z. Sali Bytyqi	z. Leonard Shala	
z. Reshat Selimaj	z. Dugagjin Palushi	
z. Shefket Kuçi	znj. Laureta Tafaj	
z. Bexhet Kuçi	z. Gëzim Kryeziu	
z. Aziz Bytyqi	-----	
z. Gazmend Gashi		
znj. Besa Kuçi		
znj. Mirlinda Muqa		
znj. Vlora Neziri		

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. **Miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
 2. **Shqyrtimi i projekt vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve "EMBLEMA E Artë", "Skenderbeu" dhe mirënjohjen "13 Qërshori";**
 3. **Shqyrtim i projekt vendimit për caktimin e lokacionit për klasifikimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale;**
 4. **Informata për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar –mars 2018**
 5. **Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar –mars 2018**
- 6. Pyetje dhe përgjigje**

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi

Kryesuesi - i përshëndeti të pranishmit, njofton për rendin e ditës kërkoi të votohet.

Ardian Shala- I përshëndet të pranishmit ,Sa i perket pikës se 5 rendit të ditës ,kolegët më kan njoftu se në komitet për politik dhe financa kan kerku që me pas ni raport me shkrim ,kërkon që të shqyrtohet për takimin e ardhshëm.

Kryetari – Përshëndet të pranishmit ,nuk i pengon për shtyerjen e pikës 5 të rendit të ditës për seancën e ardhshme .

Kryesuesi-Kerkan të votohet nga ana e të pranishmeve per te mos u shtyr per seancen e ardhshme ky rend i ditës
Miratohet me 15 vota per dhe 13 kunder

Pika e parë - Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar

Aprovohet

Pika e dytë- Shqyrtimi i projekt vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve "EMBLEMA E Artë", "Skenderbeu" dhe mirënjohjen "13 Qërshori";

Kryesusi – njofton për pikën e dytë.

Kryetari -kerkoj të zvoglohët numri i mirënjohjeve "13 Qërshori" herave tjera ,nuk po më duken të arsyeshme.

Shefket Kolgeci –përshëndet të pranishmit ,këte projektvendim e përkrahim ,por kërkojmë sqarime shtesë të paktën nga një biografi e shkurtër,kur kanë lindë ,kur kanë vdek ,kontributin e tyre ,në pika të shkurta ta dimë periudhen kohore kur kan jetu kta njerëz, më së tepërmi "Emblema e Artë", "Skenderbeu" dhe per "13 Qershorin" nëse ka një biografi të shkurtër,por këto dy të parat kan një karakter më shumë dhe duhët një biografi pak më e

thurt të jetë,të informohen delegat,por edhe qytetaret kush kanë qenë, qka kanë bërë,nuk kemi kundër dhe skemi asnjë vrejttje mirëpo kerkojmë vetëm një biografi.

Leonard Shala –përshëndet të pranishmit dhe thot se jemi pro këtij projekti po që perveq se duhet me na ardh si dokumentë mendoj që brenda dokumenteve duhet të ketë një CV dhe mendoj qe kjo rregullare te ndryshojë urgjentisht për vitin tjetër me marr shpërblime ma meritore të cilët kanë kontribu për këte shoqni ,mos me qenë numri kaq i madh i mirënjohjeve, mirëpo meqenëse këto dokum kanë me mbet në arkivën e komunës dhe vendimin po e merr institucioni më i lartë i vendimmarrjës unë mendoj se duhet me pas nga një CV për secilën, në mënyr që me pas gjeneratat e ardhshme si dokumentacion.Faleminderit

Ardian Shala-kërkon gjithashtu të shkarohët cili është motivacioni për ndarjën e këtyre mirënjohjeve .

Dardan Berisha- e përkrahim në emër të grupit parlamentar ,të shkruhet CV për gjithë.

Aziz Bytyqi-përshëndetje ,edhe ne si grup e përkrahim këtë çështje ,dhe mendojë se është numër i madh i mirënjohjeve dhe në momentin kur ka shume ne numër, me një far forme zbehet edhe vlera dhe është mëse e udhës të kërkohet CV.

Sami Hajdaraj-se di a e keni në arkiv por kam dy emra që kanë marrë këto mirënjohje Rexh Buzhala dhe Rrahman Hamzaj dhe mendojë se nuk është e nevojshme nga dy herë të ndahen.

Kryetari-Une sa e di në këtë komision kan marrë pjes gjitha partit politike,gjdo anëtar i nje partie ka qenë ne komision asht dasht me i sqaru keto gjëra ,në fillim te shtatorit do ta ndroajme rregulloren ne bashkëpunim me partit politike do ta bëjm ne menyre transparente përzgjedhjen e ketyre mirënjohjeve .

Nexhat Ramadani- Une mendoj se asht përgjegjësi e qeveris për me pa ne arkiv kush është në ate list ,mos e merrni propozimet e ktuhit si propozime politike por përgjegjësi e qeveris është me marr listen për gjdo propozim qe del me than që në baz të dokumentacionit ton ky e ka marr mirënjohjen.

Kryesusi-ne gjat punes me komisionin kemi has ne nje emer edhe e ekemi largu.

Kryetari- Nuk thash se është pergjegjesi e partive politike sepse arkiven e ka qeveria dhe qeveria i ka këto dokumenta ,përgjegjësin e marrim na por mos te ndodhë me një gje e till.

Avni Bytyqi-vertet për mu nuk është shqetësuese ne rast se dy emra jan ktu dhe miratohet vendimi për arsye se na mujna me i tërhek ,por më shume po me vjen shqetësuese çështja se po kërkoni arsyeshmëri rreth propozimeve ,per arsye se siq tha kryetari secila parti politike e ka anëtarin e tij në komision,por nëse doni herën tjetër jau sjellim edhe Cv.

Kryetari-Nexhat e pranova gabimin në mënyre publike ,ju e dini vitin e kalun keni qenë pjesmarrës edhe ju edhe ne mbi gjysma nuk kan ardh me i marr mirënjohjet ,por këtë vit kryetari Komunes ka me i nda vetëm 1 ose 2 ,kan me i nda shokët tonë që kanë marrë pjess në luftë , shefat e grupev parlamentare ose gjeneralat ,kemi plotë të tillë ,nuk i ndajë 19 mirënjohje se pom dokët e palogjikshme ,

Kryesusi e qet në votim pikën e dyt

Aprovohet

Pika e tretë-Shqyrtim i projekt vendimit për caktimin e lokacionit për klasifikimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale;

Kryesuesi – njofton për pikën e tretë, kërkon të realizohet.

Kryetari - kemi një donacion nga ministria e planifikimit hapësinor memorandumit e kemi nenshku me Ministren vlera 3milion e 500 mijë euro ndërtohet një fabrikë për riciklimin e mbeturinave në Komunën e Suharekës , e kemi diskutuar me anëtarët e partive politike në komisoion për politik dhe financa dhe na duhet lokacioni më i përshtatshëm për me shpall tenderin ,është duke u punuar rreth kësaj çështje ,nuk kan qenë e lehtë me pru këte fabrikë pasi ka konkuru edhe Prizreni ,Gjilani , falenderimi i takon ministrës Reshitaj.

Nexhat Ramadani-Ne kemi diskutu ne KPF,jemi dakordu që të shkojë në kuvend dhe të diskutohet ,i kam ba disa pytje kryetarit në KPF,njëra prej tyre ka qenë ,edhe pse është vendimi për lokacion si e ke mendu menagjimin në të

ardhmen ,është pergjigjur se do ta formojnë nje ndërmarje komunale ,mirëpo pas konsultimit me koleget e grupit parlamentar dhe pas marrje se informacioneve dhe mas di kryetari thot se ne do ta qesim ne tender ,qe nese ke me menagju me ndermajre komunale nuk ki nevoj me qit ne tender mendoj nuk është e nevojshme ,mirëpo pas diskutimit me grupin parlamentar ne mendojm që për të mos e pengu kete proces ,por për të bere projektvendime te mira ,ksaj radhe mos ta votojm ,jemi kunder per disa arsye ,mendojm se ky projektvendim nuk eshte si duhet ,e para kategoria e tokes është kategori e klases tpar nbaz te cilit kompetente per ndrrimin eshte misnitria ,ju diqka që nuk është kompetencë e komunës e keni qit në projektvendim ,tjetra eshte se ne në këtë hapsirë para ni kohe kemi marr ni vendimë per ndertiminn e stadiumit për të cilin e kemi kalu për interes të qytetarëve dhe pse nuk jan zhvillu procedurat si duhet ,dmth jan disa pengesa ,paqartësi, dhe kësaj radhe jemi kundër edhe pse e qmojm gjdo përpjekje te kësaj sfere,Faleminderit.

Kryetari –Ndoshta jemi keqkuptu ,Ne nuk jemi tu shpallë tender për kompani publike ,shumë shpejt do ta shpallim tenderin per ndërtiminin e fabrikës ,kjo eshte për fabrikë jo për kompani ,fillon ndërtimi fabrikës pasataj fillojmë me procedura tjera ,mas 10 dite i ftojë shefat e grupeve parlamentare dalim në teren ,nëse gjejmë vend më të mirë në zonën industriale ,shkojmë në zonën industriale ,nuk po shoh diqka gabim ,ne po kërkojmë lokacionin , memorandumi është nënshkru dhe e qesim tenderin , i vazhdon procedurat tjera komuna.

Nexhat Ramadani-Kryetar nuk është e sinqert me bo politik ne këte form ,na nuk jemi kundër, e kemi përshëndet dhe e përshendesim gjdo iniciativ por ti duhet me ju thanë qytetarve që ti nuk i merr parasyh hiq ata ,dhe delegatët i vë para pozitive të këqija ,ky është thelbi ,absolutisht kerkush ska me ta marr meritën nëse ki me realizu diqka të tillë ,nëse ju jeni te sinqertë jem të bindur që për ni afat të shkurt mundeni me pru projektvendimin qysh duhet ,duke kry krejt procedurat në bazë të ligjit .

Leonard Shala – Faleminderit Kryesus ,Nexhati e përmendi KPF – në ,ne sot jemi duke folur për lokacionin ,përgjegjësit a realizohet a jo ,ne ti merr kryetari për me shndërrua tokën ,jemi duke fol per lokacion edhe une jam me ba diskutime publike ,une ne KPF kam kërku ,meqenëse kjo parcella materialin qe e keni diku 25h ,pjesa e parë është nda për varrezat e studenqanit ,pjesa e dytë për fushën sportive kisha deshtë këte pjesë me analizu a është mir me zhvendos diku tjetër .Sot po flasim për një përfitim që ka fitu komuna suharekës dhe duhet të falënderojmë atë që ka qenë akter për realizimin e këtij projekti,ne e mbështesim me vrejtejet që kemi thën sa i perket lokacionit për vendosjen sa ma të mirë në këtë hapsirë dhe ndoshta është desht që për këtë lokacion prej 25h me pas një planë rregullues .Faleminderit

Ardian Shala-Ne jemi për t'i ndjek procedurat ,nuk është në rregull me leju një formë të tillë,e përshëndesim mirëpo kërkojmë të rishikohet, mendojmë që ma mir pak ma vonë edhe mirë se me shku keq ,kështu mendojë .

Rilind Krasniqi-Un deshta me bo një pyetje për drejtorinë përkatëse dhe per kryetarin ,A shkojnë dyat bashkë fabrika për riciklim dhe stadiumi nuk e di sa është mendu ,a ka vizion për këtë çështje,apo vetëm po dëshironi me shfrytëzu si hapësire që është aty edhe me ja qit pikën?

Kryetari– Replikon dhe e sqaron planin për të analizuar lokacionin e ndërtimit të fabrikës,jam duke u befasue per arsye se nje donacion i till me shkaktu probleme ,e cek perseri qe mbas 10 dite mundemi me dal me shiku analizu dhe njer her lokacionin ,kompania publike eshte tjetër sen ,jemi duke kerku lokacion per ndertimine e fabrikes .Nuk dua të hy në të kaluaren ,ju e keni per detyr me kritiku ,edhe i pranoj ne qoft se jan te sakta ,por qka doni me than tash qe vijin edhe 3 milion euro ne zon industriale ,2 milion e500 mij per ambient te keqija ? jeni msu mos me marr pare jeni msu me fjet ,ska problem .

Leonard Shala –Ardian tregom ku po shkelet procedura ?Debati me qytetarë nuk është procedur.Nuk po du me pa pushtetin tu gabu, skeni dal me u ba pjes e aksionit per pastrimin e mbeturinave ,ne e kemi kete pun me qen afer qytetarit edhe spo pranoni me qen pjes e kshilleve ,se po duhet u marr me probleme te qytetarve , duhet t'a mbështesim kur ka nevojë, nese veq gabon diku un do te jemi i pari qe ka me kundershthu mirëpo ne iniciativa me vullnet te mir do te duhet ta pershendesim ,t'i lëm subjektet politike.

Nexhat Ramadani –Quane si të doni ,skemi kurrfarë përshtypje dhe nuk e mbështesim kryetari tha se mbas 10 dite do te dalim ta caktojm lokacioni ,qka ka nevoj me dal mbasi sot e merr vendimin nese i ndjekim procedurat kuruar kundershtimi ska me pas , ne te pergezojm pe rate qe keni bo deri tash edhe nese eshte e vertet donacioni dhe pse memorandumin nuk e kemi pa .Nuk ka seriozitet, të vazhdojmë mos me i shkel ligjet.

Kryetari –Para dy viteve keni marr 5h toke , është afer me këtë ,për deponi legale për mbeturina ,sipas juve a është ma mir farika për riciklimin e mbeturinave apo deponia ,une nuk jam tu bo politik ,kemi bisedu në KPF ,na duhet lokacioni me i vazhdu procedurat e tenderimit ,formojmë komision dalim ,aty ku ka zonë industriale e ndërtojmë fabriken ,edher nese kena gabu gabimet i permisojmë .mas qershorit ka me ndryshu formën e punes .i Fton ne debat publik qe do te mbahet te premten .

Aziz Bytyqi – U bë debat dhe jan përpjek me analizu ,nuk ka shkelje ligjore,nuk po shoh ,është projekt për ndarjen e lokacionit ,nëse ka shkelje ligjore ,ju lutem i referoi ligjit i referoi nenit dhe ne nuk po shkojmë ne nje vendimë të kunderligjshëm.

Dugagjin Palushi-Mendojë çështjeve të tilla duhet me ju lën kohë të diskutohet pse jo edhe debate me qytetar pastaj duhet me u specifiku se qfar mbeturina do te riciklohen aty t’a shikojmë a ju përshtatet lokacioni dhe qytetarëve,mendojë ta lëm në asamblen e radhës.

Reshat Seliamj-Përshendetje, Nexhat Ramadani tha se nuk po bëjmë politik,bash politik je tu bo ,jemi duke kërku lokacionin,procedruat tjera vazhdojnë., ti e din se ni kryetar si Balia është shumë i vetdijshe ne keto gjëra ,sa i përket juve qe pritni mu angazhu ju nuk angazhohi fare ,juve ju pengon dhe nuk keni qen prezent ne rastin e Talat Xhaferit ,ju nuk keni qen ne aksionin e madh ,qe ka qen mediatike ne nivel te Kosoves ,aksioni mbeturinave,keni qenë shume pasiv ,zoti Ramadani ish drejtor i shperbimeve publike 60% ka kthy subficit ju nuk jeni bashkëpunues fare nuk jeni punëtor fare .Faleminderit

Florije Bytyqi-Përshendetje,Sot do të marrim vendim vetëm për të caktuar lokacionin,ta sqarojmë a është vendi i duhur ,këto duhet me i diskutu.,mirëpo a asht e arsyeshme aj vend ne duhet me sqaru dhe kerkojm që në për me ndërto një vend të till ministria e Ambientit a na lejon neve tokën e klases të parë me shndërru në Tokë të një fabrike ,Keto neve sot na interesojnë ,kërkojmë prej juve të formohet një komisionë prej grupit të Kuvendit , me dal me caktu një lokacionë masi kemi aq mospajtime.

Kryetari-Do ta qesim në votim,ne e kemi caktu ,qështje e juaja është a doni me votu.

Gazmend Gashi-Me pas mundësinë me ndrru me një vend tjetër.

Kryetari-Jemi largu diku 5h i kemi lan hapësire është fusha sportit.

Shefket Kuci –Duhët të debatojmë për masat që duhen të merren për rregullimin e këtij projekti

Kryetari –Tregon planin e planifikuar për këtë projekt. Do te ndahën letrat veq ,gjami veq metali veq, mbeturinat shkojnë në Landovicë ,materiali shitet edhe letra shitet dmth nuk eshte me ndot ambientin.

ARDIAN SHALA-Po du mu ndërlidh me kolegët që e diskutun punën e bashkangjijtëjs nëper aktivitete ,Sa herë që kan ardh neve na kan thirë me vones , është dashtë me deabtu në Kuvend e mu informu.

Nexhat Ramadani -shumë qartë thjesht kërkojmë të zhvillohen procedurat e këtij projekti.

Florije Bytyqi-Nexhat sa e ki respektu ti debatin me qytetarin?

Leonard Shala- hajde t’a avansojmë pak , unë shumë her i kam thën Kryetarit me na dhën punë edhe neve sepse ne jemi të zgjedhur prej qytetareve t’a përkrahim kur e ka mir qeverisja ,qka ka tkeqe me shku institucione komunale ,me thir kryetarin ,un e kam thyer ma ka qel 3her tel per probleme te ndryshme . t’a lëm anash politikën.

Xhemajl Kabashaj -U debatu shumë ,jemi të interesuar ne zgjidhjen e problemit por dëshirojm të zhvillohen procedurat,na u duk jo e formulune mire ,e para është vendos afer stadiumit qe u cek ,te pika 1.2 nga sipërfaqja e përgjithsme e parcelues e cekur në piken l neni l te këtij vendimi ndahën 1500m katror dhe thot se i ndrrohett destinimi dhe me planin zhvillimor ,ndrrimi destinimit prej tokës bujqesore ne një tok të ndërtimit eshte kompetenc e Miniistris Bujqesis ,keto jan arsytet qe nuk po me bindin me votu.

Bashkim Ndrecaj-Ne jemi punëtorë i përkrahim projektet, Reshat kam qenë ne grejkoc me kqyr per uj ,jam mundu me tndihmu me zgjidh qështjen ujit ,Lardi pom vjen mir qe e ka mar rolin e zevendsit kur the se skan marr pjesë ne aksion ,je kan bashk me mu ne aksion ,ju kam përgjigjë në gjdo ftesë që e kan ba ,kryetarit dhe drejtorit të shërbimeve publike punoni ju pak ma shumë edhe ne jemi tu punu.

Kryetari-Kjo fabrik është në interes te qytetarëve me u ndertu dhe do te ndertohet.

Kryesuesi-E caktojme lokacionin,fitohet grandit dhe fillojnë procedurat tjera..E qesim ne Votim

Aprovohet

Pika e katërt- Informata për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar – mars 2018

Kryesuesi-Njofton për pikën e katërt.

Gëzim Kryeziu -Përshendetje ,i kam 2 pika që më interesojnë ,taksat për lejën ndërtimore, pse kaq pak mjete janë marre prej kësaj takse?kam dëgju se është dhënë një pëlqim P+4 ,një person që merret me ndertimë si do ta ndertoj aj p+4 kur në planin zhvillimor nuk është p+4,,dhe mendoj që2000 euro për3 muaj për leje ndërtimore janë shumë pak si dhe drejtorin për ekonomi e pergezoi për punen e ka rri fitimin për 26 mije euro rreth tatimit në pronë.

Ardian Shala-Në raport përshkruhet se nuk ka asnjë shpenzim kapital ,nuk kuptoj si do të menagjohët buxheti vetëm për 6 muaj te vitit qe po mbeten kur për 5 muaj nuk është lëshuar asnjë cent ,gjithashtu edhe për të hyrat vetanake ,po shihët në tabel që kemi 46mijë euro më pak nese krahasojm me vitin paraprak qe i bie 184 mij euro munges ne total nderrsa ne krahasim me planifikim ka 142 mijë euro më pak që i bije gjysmë milioni më pak për ni vit ,gjithashtu i keni specifiku edhe të hyrat e tatimit në pronë ,ju pergezoi për këtë ,kemi edhe kategori tjera që inkasohen prsh,certifikata ,shëndetesia ,arsimi ,denimët qiraja etj gjithashtu te drejtoria e shërbimeve publike është vlere e telefonisë fikse mbi 1000 euro ai përket të gjitha drejtorive në përgjithesi apo vetëm asaj drejtorie.

Kryetari-i përgjigjet Gëzim Kyreziut besoj se e din qe planet rregullative jan anulë ,edhe përderisa nuk ka plane rregullative nuk ka mundesi me dhan leje,Ardian –ke te drejt por duhet me ditë qe buxheti nuk ka ka kalu deri ne prill kemi pas probleme ,dhe asnjë procedur nuk mundet me fillu pa buxhet,një tender i merr45 dit ,jemi tu punu dhe kemi me ja arrit mos me mbet subficit.

Leonard Shala-Kryetar te zyra e juj më interesoj me dit i keni subvencione 13,845euro , kush është subvencionu me këtë shumë të mjeteve ,shoh gjithashtu të hyrat nga denimët në trafik, ta zëm në periudhen paraprake të vitit 2017 kemi pas 13270 euro kurse sivjet i kemi 21422 euro ,nuk mendojë që duhet me pasë shumë vullnet me lëshu denime ,mendoj që është dasht me qenë e fokusume edhe në drejtime tjera ,tu bazu në ndodhitë e fundit të rasteve me pasoja fatale ,te këtë siguri në stacion të autobusëve ,apo rreth objekteve shkollore si dhe drejtori i Kulturës kei subvencione me vlerë prej 12485euro ,kishe me qenë mirë me tregu cilat kan qenë kriteret e këtyre subvencioneve dhe kush është subvencionu.

Kryetari-i përgjigjet Leonardit ,te subvencionët është një rregullore dhe se në këtë vit është nje grup i grave ,që kanë shpreh gadishmërinë që kësaj here mjetet e planifikuara pë festën e 8 marsit me ju nda grave te prekura me kancer që numri i të prekurave me këtë semundje kalon mbi 100 ,te denimet nuk kemi marveshje por është rrit numri i denimeve për kundervajtje ,

Avni Bytyqi-Ngritja e qeshtjes se denimeve në trafik ,për mu nuk është shqetuesese por mendojë qe duhet me i falenderu policien për arsye se qështja e sigurisë duhet të jetë në nivel te duhur dhe gjobat ne trafik janë rritur me ligjin për Kundërvajtjet.

Dugagjin Palushi-Te drejtoria arsimit ,udhëtimet zyrtare mrenda vendit 14247 dhe akomodim dikun 5000,dmt8 20mije euro mrenda 3 muajve ,qka jan keto shpenzime me specifiu.

Kryetari-Shpenzimët janë për motren Jehonë që ka banu te Hotel Voci ,dmth duke ditë që vazhdimisht ka punu për Komunen tone ,pjesa tjetër është për bartjen e nxënësve të fshatit grejkoc ,derisa i kem kry procedurat dmth edhe keto kanë bërë pjesë në atoshpenzime .

Aprovohet

Pika e pestë - Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar –mars 2018

Kryesusi –Njofton për Pikën e pestë dhe fton Kryetarin që të raportojë për periudhën janar-mars

Kryetari –Raporton për punët e kryera gjat kësaj periudhe dhe thotë që do të vazhdojmë të punojmë deri në fund.

Dardan Berisha – I shih kunders këtij raporti në parim për shkak se nuk është i specifikun mirë ,sqaron rezultatet shkollave të mesme ,parregullësit që po ndodhin etj,

Kryetari-është e vërtetë që përballemi me probleme në gjendjen e arsimit ,mirëpo për keto muaj nuk kemi mundësi me i rregullu të gjitha parregullësit ,përveq nxënësve që kanë shumë mungesa ka edhe arsimtarët e profesorat por prej shtatorit,gjdo mësimdhënës që mungon në vendin e punës pa arsye nëse mungojnë 1 her 2 kem me jau hek ,nuk kanë me marrë paga të plotë nëse mungojnë në proces të mesimit.,

Remzi Bytyqi –Përshendetje ,Dardan.Berisha ka kërku raportin nga drejtorja arsimit ,për arsimin në përgjithësi ,vertet ka qenë një sfidë e madhe ,kemi marrë raporte për secilën shkollë ,dhe jemi në gjendje me ju përgjigje për secilën pyetje tuajen ,që në fillim kemi filluar me marr me këtë që është për përmisimin e gjendjes në arsim ,kemi hartu një plan prej 36 rekomandimeve ,kemi angazhu grup punues që na ka shërby dhe po na shërben për përmisimin e gjendjes në Arsim, gjithashtu kemi parashtr pyetje rreth mesimit zgjedhor ,ka pas shume defekte dhe skemi mujt me përmisu këtë që është për arsye se ka punëtor me kontrata deri me 31 Gusht.Do ti korigjojmë të gjitha parregullësit.

Kryetari-Hajdeni të punojmë bashkë dhe të hecim përpara ,sepse ka mundësi me punu shumë edhe me hup në fund dhe anasjelltas ,varet prej shumë proceseve ,qka të mundemi me ndryshu të ndryshojmë e sidomos në arsim ,kemi me qenë gjdo herë transparent para juve.

Leonard Shala-Gjatë kësaj periudhe ,jeni pa si kryetar mjaftë aktivë ,gjatë angazhimeve tuaja si kryetar në teren ,mendoj se performanca e qeverisjes duhet me u mat me premtimet me transparencën edhe me llogaridhënien. Premtimi i bazenit të ujit në biraq në muajin e parë të qeverisjes,mandej ti mthe nuk kanë me shku 2 muaj kemi me shku bashke me pre shiritin ,pse spo ndërtohet aj bazen.,rruga për shirokë ,gjithashtu kam bërë një kërkesë të drejtorja e bujqësisë ,kam mbledh më shumë se 20 nënshkrime,rreth një problem të grumbullimit të ujit në disa ara ,nuk kam marrë asnjë përgjigje, mendoj se keni këtu një shpërputhje me drejtorët në krahasim me aktivitetet e tuaja si kryetar gjatë këtyre muajve.

Kryetari –Sa i përket bazenit ,këtë punë e ka kontraktu një kompani nga Deqani, është shpall tenderi ,është tenderi i Hidroregjionit në bashkëpunim me një kompani zvicerane,ndërsa rruga në shirok , kemi me rregullu,na duhet pak kohë.

Gzim Kryeziu-Kam shqetësime të banorve të rruges Xhavit Sylaj,kompania që ka ndertu atë rrugë a ka marrë referenc negative,skaj kushte me lëviz në atë rrugë.

Pyetje përgjigje

Laureta Tafaj-Grupi punues kërkon që prej javës tjetër të mirre psikolog për shkak të ngjarjeve të fundit në Prizren,Komisioni për shqyrtimin e bursave kërkon ndryshim të rregullores ,muri në Grejkoc të fusha e sportit Drejtorit të shërbimeve publike?

Kryetari – jemi duke bisedu me drejtorin për 3 shkollat e mesme me punsu nga një psikolog ,sa i përket rregullores e ndryshojme dhe atë ,ndërsa të muri do të gjejm metoden për rregullimin e asaj pjese.

Shefket Kolgeci- Drejtorit të shërbimeve publike , nuk me ka ftu me marr pjes gjatë fillimit te rrugeve ne Vraniq?

Kryetari-Ki plotësisht të drejt ,Drejtori i shërbimeve publike duhet me i ftu asambleistat e gjdo fshati qe fiillojn punimet ,sa i përket projektit tëbuxhett ne vraniq nuk e kemi ndryshu ,asht 10% ashtu qysh ka qenë ,rrugët jan duke vazhdu me u punu ,ndersa për kanalizimin ne kemi ardh në fund të dhjetorit ka qenë e pamundur me u fillu për shkak të sasis së ujit ,ajo duhet me u kry diku ne muajt korrik gusht .

Aziz Bytyqi-Ngrit shqetësime të fshatit Nishor ,problem kryesor është që fshtati Nishor nuk është i kompletuar kanalizimi,si dhe në afërsi te lagjes Brahaj ekziston një sipërfaqe me hektar ku hedhen mbeturinat që jan tepër shqetësuese ,kompania per pastrimin e mbeturinave dhe pse ka kushtet teknike nuk shkon me pastru atë pjes ,Kryetar dhe drejtor i shërbimeve publike ,Qka dhe kur do te intervenoni ne fshatin Nishor ?

Kryetari – I pergjigjet se do te mundohet t”i rregulloj këto probleme sa më shpejt.

Dardan Berisha –Pyet për Rekomandimet qe kan dhënë ?

Kryetari –Per ato rekomandimet ka me u punu rregullorja, ka me u be debat publik ,kan me u kthy me sugjerime .
Dardan Berisha – Sa i perket rregullimit apo sanimit te kanalit të ujrave të zeza ne fshatin Gjinoc te lagjja Hamzaj pas gjdo reshje aty bëhet rruga e pakalueshme .

Kryetari –Duhet me bo marrëveshje me arrit me e rregullu atë pjes .

Dugagjin Palushi-Paraqet disa kërkesa për fshatin Budakovë, për ndërtimi i murit te sheshi Besim Ndrecaj mendoj që po ja prish jehshin ajo pjesë , a ka të drejt pa lejen e komunes me e vendos atë ,një pom e benzines që po ndertohet afer Autostrades disa banor afer kan shqetësime ,rreziku prej karburanteve ,te tenderët që jan dhën cilat jan firmat qe kan fitu ato tendere, ju përgëzoj 8 punsime që kishit bërë,gati te gjith ken të AAK-së dhe PDK-se dhe në asamblen e kalune kemi votu për dhënien afatgjatë ne shfytëzim të disa parcelave dhe benë lutje për një aksident qe ka marr jeten dy personave te fshatit budakovë kërkon për njerin me ndihmu me ia rregullu një shtëpi.

Kryetari- Pergjigjet rreth këtyre qeshtjeve.

Sali Bytyqi-e pergezton kryetarin për promovimin e tij deri tash ,si dhe e benë një pyetje ,pas aksionit te pastrimit të mbeturinave ,sa keni marr përgjegjësi për me mbajt kët tendenc të mirmebajtjes dhe sa është obligative komuna ne ngarkesa të denimeve të qytetarve te cilët bëjnë hedhjen e mbeturinave ,dhe a ka mbri inspeksioni me bo deri sot ndonje shqiptim te ndonje rasti.

Kryetari – i jep përgjigje

Ardian Shala- I bën pyetje drejtoreshes së shëndetësisë,kam dëgju që jan punsu ne Caritas 2 Mjek ,me qfarë procedura ? dhe e dime që në konkursin e kaluar jan eliminu disa mjek a janë marrë parasysh ata për kontributin që kan dhëne aty ,dhe nje pyetje per zyrtarin ligjor kam ba një kërkes me lyp procesverbalin për punsimin në caritas a është e drejt ligjore me kerku asamblisti me kerku procesverbalin sepse jan përgjigjur që nuk ki drejt me kerku procesverbal ?

Kryetari- Jep përgjigjje

Avni Bytyqi- Qeshtja e rregullimit te qasja në dokumente publike është e rregullune ne mënyrë decidive me ligjin për qasje në dokumente publike i cili përcakton 3 forma ,qasjen në mënyre verbale ,qasje përmes postes elektronike dhe qasje nepermjet dokumentit zyrtar, une besoj që proces verbali esht i hapur për të gjithë qytetarët për arsye se nuk është dokument konfidencial.

Takimi përfundoi në ora 16:00

**Proces mbajtësja:
Dorarta Shabani**